FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 130

Tiranë – E hënë, 13 korrik 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 36/2020, datë 9.7.2020	Për miratimin e strukturës, organikës dhe nivelit të pagave për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë.....	7703
Vendim i Kuvendit nr. 37/2020, datë 9.7.2020	Për deklarimin e përfundimit të veprimtarisë së Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"..	7704
Vendim i Kuvendit nr. 38/2020, datë 9.7.2020	Për një shtesë në vendimin nr. 100/2017 "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e Komisioneve të Përhershme të Kuvendit", të ndryshuar.....	7705
Vendim i Kuvendit nr. 39/2020, datë 9.7.2020	Për emërimin e zotit Jonaid Myzyri kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik.....	7705
Rezolutë e Kuvendit datë 9.7.2020	Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2019.....	7705
Rezolutë e Kuvendit datë 9.7.2020	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2019.....	7707
Rezolutë e Kuvendit datë 9.7.2020	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2019.....	7709
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 534, datë 8.7.2020	Për miratimin e Raportit Vjetor për Ndihmat Shtetërore të vitit 2019.....	7710
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 535, datë 8.7.2020	Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet.....	7720
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 536, datë 8.7.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 47, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendrore", të ndryshuar.....	7724

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 542, datë 8.7.2020	Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës, për të transferuarit brenda ndërmarrjes, të tipit "A/TN".....	7725
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 543, datë 9.7.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për blerjen e apartamenteve, që do t'iu dhurohen familjarëve të viktimave si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019, nga Bashkia Kamzë.....	7730
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 10, datë 9.7.2020	Për mënyrën e marrjes së mostrave, për ndryshimin e kategorisë së resursit nga tokë e pafrytshme dhe tokë urbane truall, në tokë bujqësore dhe kryerjen e analizave.....	7731

VENDIM
Nr. 36/2020

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE NIVELIT TË PAGAVE PËR AKADEMINË E SHKENCAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 2/a, të ligjit nr. 10 405 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve" dhe nenit 22, pika 5, të ligjit nr. 53/2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë",

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e strukturës, organikës dhe nivelit të pagave për Akademinë e Shkencave në Republikën Shqipërisë, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 9.7.2020.

Lidhja nr. 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

STRUKTURA, ORGANIKA DHE NIVELI I PAGAVE I AKADEMISË SË SHKENCAVE

DREJTIMI INSTITUCIONAL SHKENCOR

		Numri	Kategoria
	KRYESIA	**4**	
	Kryetar	**1**	**C (0.68)**
	Zëvendëskryetar	1	D (0.6)
	Sekretar shkencor	1	D (0.6)
	Sekretare e Kryesisë	1	III-b
	SEKSIONET SHKENCORE	**4**	
	Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjie (anëtar Kryesie)	**1**	**E (0.55)**
	Sekretar teknik i SSHSHA-së	1	IV-a
	Kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore-Teknike (anëtar Kryesie)	**1**	**E (0.55)**
	Sekretar teknik i SSHTN-së	1	IV-a
	QENDRA E PROJEKTEVE DHE KOORDINIMIT TË KËRKIMIT SHKENCOR	**4**	
	- Drejtor	**1**	II-b
	- Koordinator kërkimor-shkencor	3	III-b
	ADMINISTRATA		
	KANCELARI	**1**	I-b
	SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE PUBLIKUN	**2**	
	- Specialist për burimet njerëzore	**1**	III-b
	- Specialist për marrëdhëniet me jashtë	1	IV-a
	SEKTORI I BOTIMEVE SHKENCORE	**6**	

	- Përgjegjës sektori	**1**	III-a1
	- Redaktor shkencor	1	III-b
	- Redaktor shkencor	**1**	III-b
	- Bibliografe	1	IV-a
	- Bibliotekare	1	IV-a
	- Editor botimesh	1	Kl. VI
	SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS	**4**	
	- Përgjegjës sektori	1	III-a1
	- Specialist finance	1	IV-a
	- Specialist për shpërndarjen e librit akademik	1	IV-b
	- Magazinier/ shofer	1	Kl. VI
	SEKTORI NDIHMËS		
	- Shofer	1	Kl. IV
	- Punëtor mirëmbajtës	1	Kl. IV
	- Punonjës pastrimi	1	Kl. I
	- Arkivist-protokollist	1	Kl. VII
	TOTALI	**29**	

VENDIM
Nr. 37/2020

PËR DEKLARIMIN E PËRFUNDIMIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PAVARUR PËR KOORDINIMIN, MONITORIMIN DHE NDJEKJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 115/2016 "PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË"

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 288 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar dhe nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Deklarimin e përfundimit të veprimtarisë së Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 74/2018 "Për ngritjen e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 'Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë'", të ndryshuar.

II. Dokumentacioni administrativ i krijuar nga Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", në përmbushje të detyrave të tij, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, i kalon dhe administrohet nga Kuvendi i Shqipërisë.

III. Me përfundimin e veprimtarisë së Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", përfundojnë edhe mandatet e anëtarëve të Komisionit të emëruar me vendimin nr. 97/2018 "Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe vendimin nr. 109/2018 "Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 'Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë'".

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 9.7.2020.

VENDIM
Nr. 38/2020

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 100/2017 "PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, neneve 21/1, 55, pikat 2 dhe 3, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar Demokraci dhe Drejtësi,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 100/2017 "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

I. Deputetja Majlinda Halilaj caktohet anëtare zëvendësuese në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 9.7.2020

VENDIM
Nr. 39/2020

PËR EMËRIMIN E ZOTIT JONAID MYZYRI KRYETAR I KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 19/2, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Jonaid Myzyri emërohet kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 9.7.2020.

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2019

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin dhe rëndësinë e organeve të barazisë në një shoqëri demokratike, ku të drejtat dhe liritë themelore të çdo individi duhet të respektohen;

Duke vlerësuar rolin e Avokatit të Popullit si institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike;

Duke vlerësuar rolin e Avokatit të Popullit në nxitjen e standardeve më të larta në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, si dhe rolin proaktiv në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në veçanti të grupeve më të margjinalizuara në shoqëri;

Duke vlerësuar rolin e Avokatit të Popullit në transparencën e veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi;

Duke nënvizuar rëndësinë e rekomandimeve të këtij institucioni për respektimin e të drejtave të njeriut nga administrata publike, si dhe rolin e vet Kuvendit në ndjekjen sistematike të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet në nivel qendror dhe vendor;

Duke vlerësuar angazhimin e Avokatit të Popullit në përmirësimin e legjislacionit nga këndvështrimi i standardeve më të larta të të drejtave të njeriut dhe bazuar në gjetjet e hetimeve administrative të tij;

Duke vlerësuar rolin e zyrave rajonale të Avokatit të Popullit në promovimin e këtij institucioni dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në të gjithë territorin ku këto zyra ushtrojnë veprimtarinë e tyre;

Duke risjellë në vëmendje vendimin nr. 134/2018, të Kuvendit të Shqipërisë, për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik të institucioneve të pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj;

Bazuar në raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2019, në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë së datës 30.5.2019 "Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2018",

Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit për vitin 2019 konstaton se:

1. Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2019 janë përmbushur në përgjithësi, me përjashtim të dy rekomandimeve që janë në proces.

2. Publikimi i rekomandimeve të tij të nxjerra në vite, adresimi në platformën *online* të Kuvendit të Shqipërisë, si dhe informimi i këtij të fundit për zbatimin e tyre nuk ka përfunduar ende.

3. Raporti nuk përmban të dhëna të plota për zbatimin e rekomandimit për bashkëpunimin me organet homologe në mbrojtje të të drejtave të shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë vendit.

4. Numri i kërkesave dhe ankesave të trajtuara nga Avokati i Popullit është ulur në krahasim me vitin 2018 dhe vetëm 33,4 për qind e tyre ishin brenda juridiksionit të tij.

5. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në kuadër të parandalimit të dhunës dhe torturës, ka inspektuar institucione të paraburgimit dhe burgje, njësi policore, spitale psikiatrike, qendra ku trajtohen shtetasit e huaj, azilkërkuesit, viktimat e trafikimit, pika të kalimit kufitar dhe mjediset e planifikuara për të ndërtuar qendrat e trajtimit të përkohshëm të emigrantëve.

6. E drejta e pronës dhe trajtimi i rasteve konkrete ka qenë në fokus të punës së tij.

7. Trajtimi i ankesave, kërkesave dhe kryesisht i rasteve me iniciativë, me objekt të drejtat e fëmijëve, ka pasur një vëmendje të veçantë të tij.

8. Angazhimi në çështje që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe komunitetin LGBTI është rritur.

9. Numri i rekomandimeve të adresuara organeve të administratës publike dhe të zbatuara ka njohur rritje në krahasim me vitin 2018. Nga 213 rekomandime të adresuara organeve në nivel qendror dhe vendor, 63 për qind e tyre janë pranuar, 23 për qind janë në proces zbatimi, 10 për qind janë refuzuar dhe 4 për qind janë pa përgjigje.

10. Numri i ankesave/kërkesave të adresuara në zyra vendore është rritur dhe ato përbëjnë 44 për qind të numrit të përgjithshëm të kërkesave të drejtuara gjatë vitit 2019. Zyra vendore në Bashkinë Fier është mbyllur dhe është hapur zyra e re në Bashkinë Vlorë.

Bazuar sa më sipër, për vitin 2020, Kuvendi i Shqipërisë kërkon nga Avokati i Popullit:

1. Të përfundojë procesin e hedhjes së të dhënave për rekomandimet e adresuara, të përditësojë të dhënat në kohë reale, si dhe të ndjekë në mënyrë sistematike zbatimin e rekomandimeve të adresuara.

2. Të marrë masa për pasqyrimin e plotë të rekomandimeve të Avokatit të Popullit drejtuar institucioneve të pushtetit ekzekutiv, organeve në nivel qendror dhe vendor në Platformën Ndërinstitucionale të publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë dhe të raportojë në Kuvendin e Shqipërisë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve nga institucionet qendrore dhe vendore, si dhe të pasqyrojë statusin e realizimit të tyre në Platformën Ndërinstitucionale të publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë.

3. Të rrisë angazhimin në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptarë, që banojnë jashtë vendit, duke rritur bashkëpunimin me institucionet homologe.

4. Të gjejë mekanizmat e duhur për një informim gjithëpërfshirës të shtetasve në lidhje me kompetencat dhe natyrën e kërkesave/ankesave, që mund të adresohen në këtë institucion.

5. Të rrisë angazhimin në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndërmarrë nisma konkrete në zbatim të kësaj marrëveshjeje dhe të raportojë në Kuvendin e Shqipërisë në mënyrë sistematike për nismat e ndërmarra dhe

rezultatet konkrete në fushën e të drejtave të njeriut.

6. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues, si dhe të raportojë në kohë Kuvendin e Shqipërisë për nevojën e adresimit të problematikave të përsëritura ose për të cilat kërkon angazhim nga ana e Kuvendit të Shqipërisë.

7. Të rrisë angazhimin konkret në monitorimin e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve, të barazisë gjinore, të drejtat e pakicave kombëtare dhe komunitetit LGBTI, si dhe të raportojë në Kuvendin e Shqipërisë, në mënyrë periodike, për gjetjet dhe sugjerimet përkatëse për adresimin e problemeve të konstatuara.

8. Të rishikojë strukturën dhe organikën e institucionit, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe objektivave institucionalë, në mënyrë që të adresohen problematikat për kryerjen e detyrave funksionale me efektivitet dhe në përmbushje të rekomandimeve evropiane për organet e barazisë.

9. Të përmirësojë aplikacionin "Avokati i Popullit" për të rritur efektivitetin e tij, si dhe informimin e qytetarëve për të drejtat e tyre.

10. Të ndërmarrë hapa konkretë për informimin e qytetarëve, për kompetencat e Avokatit të Popullit, në nivel qarku ku funksionojnë zyrat, nëpërmjet zhvillimit të sesioneve informuese/ndërgjegjësuese, duke angazhuar punonjësit e zyrave rajonale, me fokus grupet e shtresat e margjinalizuara, të cilat nuk kanë aksesin e duhur në informacion e nevojshëm për mekanizmat e realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

11. Të raportojë në mënyrë periodike në Kuvendin e Shqipërisë për natyrën e kërkesave/ankesave të adresuara në nivel vendor.

12. Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit duhet të jetë në përputhje me standardet e përcaktuara në manualin e miratuar me vendimin nr. 134/2018 "Për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik të institucioneve të pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj" dhe detyrimisht të përmbajë raportimin e veprimtarisë së secilit komisioner të tij.

Miratuar në datën 9.7.2020

KRYETAR
Gramoz Ruçi

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR VITIN 2019

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur AKEP-in si autoritet i pavarur për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

Duke pasur parasysh që tregu i komunikimeve elektronike dhe postare ka shënuar zhvillime pozitive në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve që u ofrohen përdoruesve duke ndjekur trendin drejt shërbimeve të bazuara në internet dhe rritjes së shërbimeve postare nga tregtia elektronike (*e-commerce*);

Duke pasur parasysh që investimet në infrastrukturën e rrjeteve celulare shënuan nivelin rekord të 10 viteve të fundit duke arritur në shifrën rreth 6.35 miliardë lekë nga rreth 4 miliardë në vitin 2018;

Duke pasur parasysh nevojën e rishikimit dhe përditësimit të dispozitivit ligjor dhe material, që siguron dhe garanton të tashmen dhe të ardhmen e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë;

Duke pasur parasysh që kemi një rritje të treguesve financiarë të operatorëve celularë për vitin 2019, gjë e cila ndikon në mënyrë të konsiderueshme në mundësinë e operatorëve për të rritur investimet dhe për të përmirësuar teknologjitë në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit për konsumatorët fundorë;

Duke konsideruar se procesi i analizës së tregut me shumicë i akses-origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare është një proces i cili ka filluar që në fillim të vitit 2018 dhe ka pasur vonesa dhe shfuqizime të vendimeve të Këshillit Drejtues të

AKEP-it, me gjithë rekomandimet përkatëse në rezolutë,

Vlerëson për vitin 2019:

Vendimmarrjen për dhënien në përdorim të frekuencave të brezit 800 MHz për dy sipërmarrësit e telefonisë celulare, si dhe vendimmarrjet e tjera apo politikat rregullatore nga ana e AKEP-it, të cilat kanë sjellë investime në teknologji të reja nga operatorët në treg duke bërë të mundur përmirësimin e shërbimeve për përdoruesit.

Bashkëpunimin me aktorët brenda vendit, si dhe me autoritetin rregullator të Republikës së Kosovës (ARKEP) për implementimin me sukses të marrëveshjes për lehtësimin e tarifave të *roaming*-ut me Republikën e Kosovës. Gjithashtu, vlerëson bashkëpunimin rajonal në kuadër të Iniciativës së Ballkanit Perëndimor, i cili u finalizua me nënshkrimin e marrëveshjes për reduktimin e çmimeve të shërbimeve *roaming* në rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Punën e bërë nga AKEP-i për diskutimin e opinioneve me ekspertë të Komisionit Evropian në nivel teknik në takime dypalëshe, si dhe në takimet e forumeve të BEREC-it lidhur me Tregun me Shumicë të Aksesit dhe Origjinimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare.

Analizën e bërë nga AKEP-i për shkaqet që çuan në daljen nga një treg i rregulluar i një operatori, gjë që ka sjellë zvogëlimin nga 4 (katër) në 3 (tre) operatorë, duke vijuar në këtë mënyrë trendin rritës të indeksit të përqendrimit të tregut, si dhe rritjen e kapaciteteve konkurruese të dy sipërmarrësve me peshën më të madhe në treg përmes marrjes së 50% me 50% të të drejtave të përdorimit të frekuencave që zotëronte sipërmarrësi Plus Communication sh.a.

Bashkëpunimin me MIE-n dhe me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) për finalizimin e procesit të lirimit të brezit 700 MHz, sipas rekomandimeve të BE-së, përmes pjesëmarrjes në grupe të përbashkëta ekspertësh, si dhe krijimin e një grupi pune nga ana e AKEP-it për hartimin e një studimi për implementimin dhe sfidat e teknologjisë 5G.

Monitorimet e kryera nga AKEP-i për nivelin e rrezatimeve të telefonisë celulare, duke iu përgjigjur edhe kërkesave, të cilat kanë ardhur nga palët e interesuara, që kanë ngritur shqetësimin për prezencën e antenave celulare në afërsi të mjediseve të punës ose banimit. Gjithashtu, vlerëson si shumë pozitiv faktin që rezultatet e këtyre matjeve deri tani tregojnë se nivelet e rrezatimeve të emetuara nga antenat celulare nuk e tejkalojnë pragun e sigurisë së përcaktuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Rrezatimi Jojonizues (ICNIRP).

Punën e bërë nga AKEP-i për konsolidimin nga 3 në 1 të rregulloreve aktuale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, e cila është ne fazën përfundimtare të miratimit. Njëkohësisht vlerëson edhe punën e bërë për konsolidimin e rregulloreve, që kanë të bëjnë me aktorët e tjerë në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për vitin 2020, të angazhohet në këto drejtime:

T'i japë përparësi vënies në eficiencë të plotë të brezave të paalokuar, në përfitim të qytetarëve dhe konsumatorëve, pasi të ketë kryer analiza lidhur me dhënien në përdorim të spektrit, përfshirë këtu edhe kombinimet teknike të tij, bazuar në programin e politikës spektrale në nivel kombëtar;

Të kryejë një analizë të hollësishme dhe gjithëpërfshirëse për aspektet e zhvillimit të qëndrueshëm në kuadër të implementimit të teknologjisë së gjeneratës së re në Shqipëri, duke përcaktuar hapat strategjikë dhe duke dalë në përfundime për vendimmarrje të mëtejshme në nivel sektorial;

Duke pasur parasysh rëndësinë e procesit të Analizës së Tregut me Shumicë të Akses-Origjinimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare, Këshilli Drejtues i AKEP-it në vendimmarrjen për dokumentin përfundimtar të shqyrtojë rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës, si dhe komentet e aktorëve në treg, duke iu referuar edhe praktikave më të mira të BE-së dhe BEREC-it;

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik për Analizën e Tregut të Telefonisë Celulare për Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare, përfshirë Terminimin e Thirrjeve Hyrëse Ndërkombëtare, AKEP-i të vlerësojë opinionet e aktorëve në treg,

si dhe rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës për të marrë vendime sa më të drejta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Duke pasur parasysh që gjatë vitit 2020 duhet bërë rishikimi për caktimin e ofruesit të shërbimit universal postar, të kryejë një analizë të strukturës së tregjeve postare. Në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh që Komisioni Evropian do të kryejë rishikim të direktivave të shërbimit postar, ku priten ndryshime për sa i përket Shërbimit Universal Postar, gjatë analizës së tregjeve postare AKEP-i të ketë në vëmendje edhe ndryshimet e direktivave nga KE-ja;

Të punojë për reformimin e kuadrit ligjor të komunikimeve elektronike në funksion të implementimit të kodit të ri të komunikimeve elektronike dhe për forcimin dhe garantimin e pavarësisë institucionale;

Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, të vijojë të monitorojë dinamikën e ecurisë së problemit të dorëzimit të pakove në adresën e individit nga Posta Shqiptare, si një kërkesë ligjore dhe e drejtë e konsumatorit, e cila edhe pas rekomandimeve të AKEP-it vijon të mbetet problem duke sjellë mosdorëzimin e një pjese të mirë të pakove në adresë të marrësit, por dorëzimin e tyre pranë zyrave postare. Gjithashtu, të monitorojë dinamikën e ecurisë së problemit të tarifave dhe kostove shtesë, që u kërkohen konsumatorëve për marrjen e pakove nga Posta Shqiptare duke kërkuar që në programin ekonomiko-financiar të vitit 2020 të Postës të hiqet tarifa e dorëzimit të objekteve postare e kolipostare, e cila është në kundërshtim me frymën e ligjit dhe parimet e Rregullores së Shërbimit Postar Universal;

Të punojë për miratimin dhe implementimin e kuadrit të ri rregullator për mbrojtjen e konsumatorit/përdoruesit, si dhe të kryejë një proces këshillimi publik për përdoruesit me aftësi të kufizuara dhe ata me të ardhura të ulëta;

Duke e rikonsideruar problemin e kabllove ajrore apo atyre të vendosura në shtyllat elektrike, si dhe përdorimin e përbashkët të infrastrukturës si një problem i cili vijon të mbetet shqetësues, me gjithë përmirësimet që ka pasur, AKEP-i të vazhdojë ta ndjekë me përparësi këtë problematikë duke e koordinuar punën edhe me aktorët e tjerë në këtë proces, siç janë organet e pushtetit vendor, OSHEE-ja dhe sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike;

Pas miratimit të rregullores përkatëse, përfshirë edhe përcaktimet për regjistrin "*Do Not Call Me*", të punojë për implementimin e regjistrit bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, për të rregulluar aktivitetet e telemarketuesve që bëjnë thirrje telefonike të padëshiruara për individë privatë. Implementimi i këtij regjistri do t'u mundësojë përdoruesve që të bëjnë *opt-out*, pra të mos marrin thirrje të pakërkuara nga kompanitë telemarketing;

Të luajë një rol proaktiv duke bërë propozime konkrete për nevojën e akteve nënligjore për trajtimin e thirrjeve drejt numrit 112 dhe numrave të tjerë të emergjencave, si dhe të vijojë bashkëpunimin me institucionet e tjera shtetërore për të bërë të mundur implementimin në të gjithë Shqipërinë të përdorimit të numrit të emergjencës 112, si një kërkesë e përsëritur si në rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë, ashtu edhe në rekomandimet e raportprogresit të KE-së.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 9.7.2020.

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2019

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur Komisionin e Prokurimit Publik si organin më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm për KPP-në paanësinë në vendimmarrje, transparencën, efikasitetin, si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë nga veprimet apo mosveprimet e autoriteteve kontraktore dhe në mënyrë të veçantë mbrojtjen e interesit publik;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm rolin që KPP-ja ka në rritjen e efikasitetit dhe të besueshmërisë në sistemin e prokurimit publik;

Vlerëson veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik, për vitin 2019, në drejtim të:

Trajtimit të një numri të konsiderueshëm prej 1141 ankesash në total, nga të cilat 1052 janë ankesat e paraqitura gjatë vitit 2019 dhe 89 ankesa të mbartura nga viti 2018;

Dhënies së 792 vendimeve themeli për 1141 ankesa të shqyrtuara gjatë vitit 2019 nga të cilat 729 vendime për ankimet e vitit 2019 dhe 63 vendime për ankesat e vitit 2018;

Rritjes së të ardhurave të derdhura në buxhetin e shtetit në vlerë 113,446,772 lekë nga tarifat e ankimit të operatorëve ekonomikë, për të cilët në fund të procesit administrativ është vendosur mospranimi i ankesës së tyre;

Dhënies së asistencës së nevojshme ligjore për aktet ligjore e nënligjore në fuqi, që prekin procedurat e prokurimit, koncesionet/PPP, ankandet e lejet minerare;

Bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucionet partnere ndërkombëtare, kryesisht i orientuar në organizimin e disa trajnimeve dhe aktiviteteve të shkëmbimit të eksperiencave, me synim rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të KPP-së për zhvillimet më të reja në mekanizmat e rishikimit administrativ të prokurimit publik në vendet e BE-së dhe rajon, si edhe me mënyrat dhe metodat më të mira të menaxhimit të institucioneve homologe.

Kuvendi kërkon që Komisioni për vitin 2020 të angazhohet në këto drejtime:

- Të publikohet në faqen e internetit të institucionit në fund të çdo viti lista e procedurave ankimuese, të cilat janë ose ka përfunduar procesi gjyqësor, fondet limite të këtyre procedurave objekt ankimi;

- Të forcohen kapacitetet administrative të KPP-së duke e bërë totalisht funksionale strukturën e miratuar nga Kuvendi deri në fund të vitit 2020, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi;

- Për të gjitha rastet kur nga shqyrtimi i ankesave konstatohen shkelje në vendimet e autoriteteve kontraktore apo vonesa të këtyre të fundit në dërgimin e dokumentacionit, të marrë masa, sipas natyrës së shkeljes së konstatuar, duke i referuar Agjencisë së Prokurimit Publik për marrjen e masave administrative sipas ligjit;

- Të marrë masa për standardizimin e vendimmarrjes dhe bërjen publike të tyre, me qëllim rritjen e efikasitetit të shqyrtimit të çështjeve, garantimin e barazisë, si dhe sigurimin e transparencës;

- Nëpërmjet bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës, të rritet bashkëpunimi me Gjykatën Administrative për sa i takon trajnimit të punonjësve të të dyja institucioneve, me qëllim aftësimin e tyre për të trajtuar çështje komplekse të prokurimit publik dhe për t'u përballur me numrin në rritje të ankimimeve, në zbatim të rekomandimeve të lëna në progresraport;

- Të plotësohet Regjistri Elektronik i Ankesave me elementet shtesë të nevojshme, siç janë edhe lloji i procedurës dhe fondi limit për çdo procedurë prokurimi objekt ankimi;

- Të rishikohet rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, të miratuar me VKPP nr. 596, datë 12.9.2018, duke marrë në konsideratë rekomandimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në përputhje me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 9.7.2020.

VENDIM
Nr. 534, datë 8.7.2020

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR NDIHMAT SHTETËRORE TË VITIT 2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, shkronja "dh", 18, shkronja "e" e 32, pika 2, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit vjetor për ndihmat shtetërore të vitit 2019, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RAPORTI VJETOR PËR NDIHMAT SHTETËRORE TË VITIT 2019

I. PËRMBLEDHJE

Raporti vjetor për ndihmat shtetërore është hartuar në zbatim të detyrimeve të sanksionuara në nenin 71, pika 5, të MSA-së, dhe në marrëveshjen e CEFTA-s 2006, për sigurimin e transparencës ndërkombëtare. Raporti është përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë mbështetur në vendimet e Komisionit të Ndihmës Shtetërore për autorizimin e ndihmës shtetërore. Në mënyrën e paraqitjes dhe të analizës së të dhënave në raport është ndjekur metodologjia e Komisionit Evropian.

Të dhënat e përfshira në këtë raport janë raportuar nga zbatuesit e skemave të ndihmës shtetërore: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Bashkia e Tiranës. Pavarësisht se ky raport është për vitin 2018, në të gjenden të dhëna për të gjithë periudhën 2016–2019, duke bërë një krahasim të ndihmës shtetërore, përgjatë këtyre viteve, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në raport me ndihmën shtetërore, të dhënë në vendet e BE-së.

Raporti jep një përshkrim të objektivave kryesorë që janë arritur në fushën e ndihmës shtetërore në Shqipëri, si dhe të instrumentet kryesore të përdorura në periudhën 2015–2019. Shuma e ndihmave shtetërore të dhëna në Shqipëri gjatë viteve 2015–2019 është vlerësuar në rreth 25,562.79 milionë lekë (198.16 milionë €), prej të cilave 8,482.45 milionë lekë (68.97 milionë €), që përfaqësojnë 0.5% të PBB-së, janë dhënë në vitin 2019. Në totalin e ndihmës së dhënë për vitin 2019, vendin kryesor (rreth 50.4%) e zënë ndihmat sektoriale, ndërsa ndihma horizontale përbën 49.6% të ndihmës gjithsej. Megjithatë, pjesa më e madhe e skemave që japin ndihmë shtetërore nuk e tejkalon kufirin *de minimis* të Bashkimit Evropian dhe, si të tilla, përgjithësisht nuk paraqesin problem në këndvështrimin e tregtisë ndërkombëtare.

Instrumentet kryesore të ndihmës shtetërore në Shqipëri gjatë vitit 2019 janë grantet dhe përjashtimi nga taksat, rimbursimi apo reduktimi i shkallës tatimore.

Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, Raporti Vjetor për ndihmat shtetërore për vitin 2018 do t'i përcillet Komisionit Evropian.

II. PËRKUFIZIMI I NDIHMËS SHTETËRORE

- Baza ligjore

Në Shqipëri, ligji i ndihmës shtetërore përcakton rregullat e dhënies së ndihmës shtetërore duke respektuar detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Ligji i ndihmës shtetërore nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, jep përkufizimin e ndihmës shtetërore, kushtet për miratimin e ndihmës shtetërore, kompetencat e strukturave përgjegjëse, procedurën e autorizimit, monitorimin dhe kthimin e ndihmës shtetërore, si edhe detyrimin për hartimin e raportit vjetor për ndihmën shtetërore.

- Përkufizimi i ndihmës shtetërore

Në bazë të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, përcaktohet se:

"Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore".

Gjithashtu neni 71 "Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike", i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë[1], përcakton se:

"Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të

[1] Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006 "Për ratifikimin e 'Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare'".

konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit."

- Përfitues i ndihmës shtetërore

Përfitues i ndihmës shtetërore është çdo ndërmarrje ose individ që, nëpërmjet akteve dhe masave të ndërmarra nga shteti, siguron përfitime financiare. Në përcaktimin nëse një masë është ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, dhe të nenit 107 (1) të TFEU-së, strukturat e ndihmës shtetërore vlerësojnë plotësimin e kritereve të mëposhtme:

- masa duhet të jepet nga shteti dhe të përfshijë burimet shtetërore;
- masa duhet të japë një avantazh ndaj ndërmarrjeve të caktuara ose sektorëve të caktuar; si edhe
- masa ndikon në konkurrencë dhe mund të ndikojnë në tregtinë midis shteteve anëtare.

Çfarë nuk përbën ndihmë shtetërore?

a) Ndihma për organet publike dhe njësive të vetëqeverisjes lokale dhe rajonale, të cilat kryejnë një aktivitet joekonomik;

b) Masa të përgjithshme të destinuara për të gjitha ndërmarrjet dhe të gjithë sektorët e ekonomisë në vend, të tilla si masat tatimore të përgjithshme etj.;

c) Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve me çmimin e tregut;

2.2 Metodologjia për raportimin e ndihmës shtetërore

Ndihma shtetërore për industrinë dhe shërbimet përfshin kategorinë e ndihmës horizontale dhe ndihmës sektoriale.

Ndihma shtetërore horizontale përfshin:

- ndihmën për kërkim-zhvillim dhe inovacion,
- ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme,
- ndihmën për punësim,
- ndihmën për trajnim,
- ndihmën operacionale,
- ndihmën për sportin,
- ndihmën për kulturën.

Ndihma shtetërore sektoriale përfshin:

- ndihmën për transportin publik,
- ndihmën për shërbimin publik,
- ndihmën për minierat,
- ndihmën për energjinë,
- ndihmën për turizmin.

Ndihma shtetërore jepet duke përdorur disa instrumente si:

A1 – Subvencione dhe grante;

A2 – Përjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulje e shkallës së tatimit ose zbritje e kontributit në sigurimet shoqërore.

III. NDIHMA SHTETËRORE NË VITIN 2019

3.1 Vështrim mbi ndihmën shtetërore në periudhën 2014–2019

A. Ndihma shtetërore krahasuar me treguesit kryesore socio-ekonomike

Tabela nr.1: Ndihma shtetërore krahasuar me disa me tregues socio-ekonomike 2014-2018

Treguesit	Njësia e matjes	2014	Shkalla e ndihmës 2014	2015	Shkalla e ndihmës 2015	2016	Shkalla e ndihmës 2016	2017	Shkalla e ndihmës 2017	2018	Shkalla e ndihmës 2018	2019	Shkalla e ndihmës 2019
PBB	mld lekë	1,395.3	0.23	1,434.3	0.35	1,472.5	0.19	1,551.3	0.24	1,630.9	0.34	1,688.9	0.50
Të punësuar (15-64 vjec)	nr	1,005,924	3,234	1,055,836	4,750	1,120,281	2,504	1,150,392	3,302	1,174,834	4,725	1,202,337	7,055
Popullsia	nr	2,889,104	1,126	2,880,703	1,741	2,876,101	975	2,873,457	1,322	2,866,376	1,937	2,862,427	2,963
Ndihma shtetërore	mln lekë	3,252.78		5,014.99		2,805.34		3,798.67		5,551.34		8,482.45	

Tabela nr.1 paraqet të dhënat për ndihmën shtetërore gjithsej në Shqipëri në periudhën 2014-2019, të krahasuara me disa tregues. Ndihma shtetërore gjithsej në vitin 2019 është dhënë në vlerën totale 8,482.45 milion lekë (68.97 mln euro) e rritur me 52.8% e krahasuar ne vitin 2018.

Shkalla e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së u rrit nga 0.34% në 2018, në 0.5% në vitin 2019.

Grafiku nr.1 paraqet shkallën e ndihmës shtetërore ndaj PBB për periudhën 2014-2019.

Grafik nr. 1. Ecuria e ndihmës shtetërore në raport me PBB 2014 –2019



B. Shkalla e ndihmës shtetërore në Shqipëri dhe shtetet e Bashkimit Evropian

Tabela nr. 2, paraqet informacion për ndihmën shtetërore në Shqipëri dhe 28 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për periudhën 2017–2018.

Tabelë nr. 2. Shkalla e ndihmës shtetërore ndaj PBB për periudhën 2017–2018

Shtetet	Periudha	
	2017	2018
Shqipëria	0.24	0.34
Belgium	0.499	0.788
Bulgaria	1.322	0.992
Czechia	1.414	1.601
Denmark	1.508	1.552
Germany	1.377	1.454
Estonia	0.992	1.022
Ireland	0.176	0.163
Greece	0.275	0.299
Spain	0.257	0.337
France	0.939	0.791
Croatia	1.239	1.541
Italy	0.24	0.306
Cyprus	0.527	0.461
Latvia	1.669	0.997
Lithuania	1.111	1.27
Luxembourg	0.255	0.239
Hungary	2.484	1.829
Malta	1.12	1.217
Netherlands	0.321	0.346
Austria	0.49	0.459
Poland	1.487	1.026
Portugal	0.515	0.449
Romania	0.505	0.545
Slovenia	0.855	0.88
Slovakia	0.296	0.475
Finland	0.828	1.156
Sweden	0.905	0.912
United Kingdom	0.439	0.38

Burimi: Komisioni Evropian, DG Competition[2] dhe MFE (%)

3.2 Kategoritë e ndihmës shtetërore

Sipas metodologjisë së Bashkimit Evropian, ndihma shtetërore ndahet në dy kategori:

- Ndihmë shtetërore horizontale, dhe
- Ndihmë shtetërore sektoriale.

Ndihma shtetërore horizontale jepet për një numër të madh përfituesish, pa dhënë preferenca për ndonjë aktivitet ekonomik, ndërmarrje ekonomike, produkt apo shërbim, duke minimizuar efektet në konkurrencë.

[2] http://ec.europa.eu/competition/state_aid/scoreboard/index_en.html

Ndihma shtetërore sektoriale jepet për aktivitete dhe sektorë të veçantë, duke pasur një ndikim më të madh në konkurrencën në treg.

Tabelë nr. 3. Ndihma shtetërore gjithsej 2015–2019 ndarë sipas kategorive (në milion lekë)

KATEGORIA	2015			2016			2017			2018			2019		
	mln lekë	mln euro	në %	mln lekë	mln euro	në %	mln lekë	mln euro	në %	mln lekë	mln euro	në %	mln lekë	mln euro	në %
Ndihma Horizontale	**4,108.04**	**29.84**	**81.9%**	**1,913.64**	**14.15**	**68.2%**	**2,379.88**	**17.86**	**62.7%**	**4,082.54**	**32.00**	**73.5%**	**4,210.44**	**34.23**	**49.6%**
Punësimi	285.34	2.07	5.7%	183.57	1.36	6.5%	196.79	1.48	5.2%	111.78	0.88	2.0%	247.73	2.01	2.9%
Trajnim	136.69	0.99	2.7%	279.23	2.06	10.0%	276.98	2.08	7.3%	150.48	1.18	2.7%	98.22	0.80	1.2%
Sport	2,058.00	14.95	41.0%	167.00	1.23	6.0%	218.80	1.64	5.8%	104.01	0.82	1.9%	121.72	0.99	1.4%
Kultura	41.15	0.30	0.8%	111.27	0.82	4.0%	39.58	0.30	1.0%	134.00	1.05	2.4%	63.32	0.51	0.7%
Ndihma operacionale	38.36	0.28	0.8%	-	-	0.0%	5.02	0.04	0.1%	1,642.90	12.88	29.6%	1,532.50	12.46	18.1%
Kerkim, zhvillim dhe inovacion	1,519.45	11.04	30.3%	1,105.64	8.17	39.4%	1,595.38	11.97	42.0%	1,895.98	14.86	34.2%	2,060.24	16.75	24.3%
SME	29.05	0.21	0.6%	66.93	0.49	2.4%	47.33	0.36	1.2%	43.39	0.34	0.8%	86.71	0.71	1.0%
Ndihma Sektoriale	**906.95**	**6.59**	**18.1%**	**891.70**	**6.59**	**31.8%**	**1,418.79**	**10.65**	**37.3%**	**1,468.80**	**11.51**	**26.5%**	**4,272.00**	**34.73**	**50.4%**
Transport publik (Hekurudha)	440.00	3.20	8.8%	390.00	2.88	13.9%	400.00	3.00	10.5%	400.00	3.14	7.2%	400.00	3.25	4.7%
Shërbimi publik	430.00	3.12	8.6%	428.70	3.17	15.3%	974.90	7.32	25.7%	1,000.00	7.84	18.0%	400.00	3.25	4.7%
Minierat	36.95	0.27	0.7%	39.35	0.29	1.4%	35.00	0.26	0.9%	68.80	0.54	1.2%	25.64	0.21	0.3%
Infrastruktura Broadband	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	491.96	4.00	5.8%
Turizmi	-	-	0.0%	33.65	0.25	1.2%	8.89	0.07	0.2%	-	-	-	2,954.41	24.02	35%
TOTALI	**5,014.99**	**36.43**	**100**	**2,805.34**	**20.74**	**100**	**3,798.67**	**28.51**	**100**	**5,551.34**	**43.51**	**100**	**8,482.45**	**68.97**	**100**

Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE

Grafik nr. 2. Ndihma shtetërore gjithsej 2015–2019

Grafik nr. 3. Ndihma shtetërore horizontale/sektoriale 2015–2019



Të dhënat në tabelën 3 dhe të paraqitura në grafikun 3, tregojnë se në vitin 2019 ndihma shtetërore sektoriale zë pjesën më të madhe të ndihmës shtetërore, gjithsej me 50.4%, ndërsa kategoria e ndihmave horizontale përbën 49.6%.

Në terma nominalë, shpenzimet e përgjithshme të ndihmës shtetërore në vitin 2019 u rritën me rreth 52.8% krahasuar me shpenzimet e vitit 2018 (+2,931.11 milionë lekë). Ky ndryshim i përgjithshëm është si rezultat i faktorëve, si: 1) rritje e ndihmës shtetërore për punësimin prej rreth 135.95 mln lekë; 2) ulje e ndihmës shtetërore

për trajnimin prej 52.26 mln lekë; 3) rritje e ndihmës shtetërore për mbështetjen e sportit prej 17.71 mln lekë; 4) ulje e ndihmës shtetërore për kulturën prej 70.68 mln lekë; 5) ulje e ndihmës operacionale prej 110.40 mln lekë; 6) rritje e ndihmës shtetërore për kërkimin dhe zhvillimin prej 164.26 mln lekë; 7) rritje e ndihmës shtetërore për SME-të prej 43.32 mln lekë; 8) ulje e ndihmës shtetërore për shërbimin publik (ujësjellësit) prej 600 mln lekë; 10) ulje e ndihmës shtetërore për minierat prej 43.16 mln lekë: rritje/dhënie e ndihmës për infrastrukturën *broadband* prej 491.96 mln lekë; dhe rritje/dhënie e ndihmës shtetërore për sektorin e turizmit prej 2,954.41 mln lekë.

Grafiku nr. 4, paraqet ndryshimin gjithsej të shpenzimeve të ndihmës shtetërore sipas objektivave ndërmjet 2019 dhe 2018 në Shqipëri (në milionë lekë).

Grafik nr. 4. Ndryshimi i ndihmës shtetërore



Burimi: MFE

3.2.1 Ndihma shtetërore horizontale

Në vitin 2019 ndihma shtetërore horizontale në vlerë absolute është 4,210.44 mln lekë (34.23 mln euro). Peshën kryesore për këtë kategori të ndihmës e ka ndihma për kërkim, zhvillim dhe inovacion me 49 %.

Tabelë nr. 4. Ndihma shtetërore horizontale 2014–2019

Ndihma Horizontale	2014		2015		2016		2017		2018		2019	
	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR
Punësimi	150.08	1.07	285.34	2.07	183.57	1.36	196.79	1.48	112.10	0.88	247.73	2.01
Trajnim	109.84	0.78	136.69	0.99	279.23	2.06	276.98	2.08	150.48	1.18	98.22	0.80
Sport	644.00	4.60	2,058.00	14.95	167.00	1.23	218.80	1.64	104.01	0.82	121.72	0.99
Kultura	-	-	41.15	0.30	111.27	0.82	39.58	0.30	134.00	1.05	63.32	0.51
Ndihma operacionale	836.33	5.97	38.36	0.28	-	-	5.02	0.04	1,642.90	12.88	1,532.50	12.46
Kerkim, zhvillim dhe inovacion	1,378.72	2.57	1,519.47	11.04	1,105.64	8.17	1,595.38	11.97	1,895.98	14.86	2,060.24	16.75
SME	37.46	0.27	29.05	0.21	66.93	0.49	47.33	0.36	43.39	0.34	86.71	0.71
TOTALI	**3,156.43**	**15.26**	**4,108.06**	**29.84**	**1,913.63**	**14.15**	**2,379.88**	**17.86**	**4,082.86**	**32.00**	**4,210.44**	**34.23**

Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE

Grafik nr. 5. Ecuria e ndihmës shtetërore horizontale 2015–2019



Grafik nr. 6. Struktura e ndihmës shtetërore horizontale për vitin 2019



Ndihma horizontale në vitin 2019 është në vlerën 4,210.44 mln lekë. Në mënyrë më të detajuar të dhënat për ndihmën shtetërore jepen më poshtë:

Ndihma për punësim: ndihma për punësim jepet nëpërmjet 7 skemave të ndihmës shtetërore. Skemat janë të miratuara me vendime të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, si më poshtë:

1. Vendimin e KNSH-së nr. 11, datë 15.3.2007 "Për skemën ekzistuese 'Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë'";

2. Vendimin e KNSH-së nr. 13, datë 15.3.2007 "Për skemën ekzistuese "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit institucional'";

3. Vendimin e KNSH-së nr. 38, datë 19.9.2011 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore 'Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta'";

4. Vendimin e KNSH-së nr. 39, datë 19.9.2011 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore 'Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë që hyjnë për herë të parë në punë'";

5. Vendimin e KNSH-së nr. 40, datë 19.9.2011 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore 'Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit për ofrimin e shërbimit të formimit profesional të punëkërkuesve të papunë nga persona juridikë/fizikë privatë dhe organizata jofitimprurëse'";

6. Vendimin e KNSH-së nr. 47, datë 28.3.2014 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore 'Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar'";

7. Vendimin e KNSH-së nr. nr. 62, datë 14.12.2015 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore 'Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit'".

Nga skema e ndihmës shtetërore me qëllim nxitjen e punësimit kanë përfituar gjithsej 513 ndërmarrje, duke punësuar gjithsej 4195 punëkërkues të papunë.

Ndihma për trajnim: skema e ndihmës shtetërore e miratuar me vendimin e KNSH-së nr. 12, datë 15.3.2007 "Për skemën ekzistuese 'Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë'",

ka si qëllim trajnimin e punëkërkuesve, të cilët më pas sigurojnë vendin e tyre të punës në ndërmarrje të cilat janë përfituese të ndihmës shtetërore. Në vitin 2019 kanë përfituar gjithsej 87 ndërmarrje, duke u trajnuar 1143 punëkërkues të papunë. Për këtë skemë të ndihmës shtetërore janë shpenzuar fonde nga buxheti i shtetit gjithsej në shumën 98.225.273 lekë.

Ndihma për sportin: komisioni me vendimin nr. 54, datë 26.1.2015 "Për skemën ekzistuese të mbështetjes me grante nga buxheti i shtetit në sektorin e sportit". Për këtë skemë ndihme, objektivi kryesor i së cilës është nxitja e kulturës së sportit, edukimit të sportit dhe aktiviteteve fizike duke rritur pjesëmarrjen e shtetasve në sport, për vitin 2019 janë shpenzuar nga buxheti shtetit 121.72 milionë lekë.

Përfituesit e skemës janë 21 federata të ndryshme sportive që ofrojnë shërbime sportive për anëtarët e tyre. Federatat shqiptare të sportit janë organizata jofitimprurëse, të cilat kanë për qëllim të zhvillojnë, promovojnë, kontrollojnë, dhe të rregullojnë aktivitetet sportive të shoqatave dhe klubeve, të cilat janë anëtarë të federatave të tyre, në përputhje me statutet e tyre. Mbështetja me grante nga buxheti i shtetit jepet për financimin për mbulimin e kostove të personelit dhe investimeve.

Ndihma për nxitjen e kulturës: në vitin 2019 ndihma shtetërore për nxitjen e kulturës është dhënë në vlerën 63.32 milionë lekë. Ndihma shtetërore është dhënë në formën e mbështetjes financiare me fonde publike për projektet me thirrje dhe në zbatim të prioriteteve institucionale në programin e fushës së art-kulturë për 144 projekte dhe aktivitete artistike-kulturore me fokus:

- platforma dhe programe të edukimit përmes artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore;
- platforma dhe projekte në funksion të turizmit kulturor;
- platforma dhe projekte që punësojnë dhe angazhojnë numër të lartë të artistëve apo subjekteve që lidhen me kulturën;
- projekte kulturore inovative-digjitale
- projekte të industrive kreative.

Ndihma operacionale: Kjo kategori përfshin skemën e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse të konsumuar në serat me ngrohje dhe industrinë. Për vitin 2019 raportohet se është dhënë ndihmë shtetërore në shumën 1,532.5 milionë lekë, nëpërmjet skemës së rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agro-industriale.

Ndihma për kërkim dhe zhvillim: Ndihma shtetërore për kërkim dhe zhvillim është dhënë për ndërmarrjet që nënshkruajnë "marrëveshje hidrokarburesh" dhe nënkontraktuesit e tyre, duke iu ofruar një përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar të të gjithë kontraktorëve dhe nënkontraktorëve për realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure. Në vitin 2019, është raportuar se kompanitë e huaja që kryejnë operacione hidrokarbure në Shqipëri kanë përfituar përjashtime në import (TVSH dhe përjashtime doganore), në shumën 2,060.24 milionë lekë (në vitin 2018 shuma e përjashtimeve ishte 1,895.98 milionë lekë).

Ndihma për SME: Në vitin 2019 nga skema e ndihmës shtetërore për SME-të kanë përfituar gjithsej 170 ndërmarrje të vogla dhe të mesme, prej të cilave 94 ndërmarrje të mbështetura nga fondet e AIDA-s dhe 76 ndërmarrje nga skema e ndihmës shtetërore të dhënë nga Bashkia e Tiranës.

AIDA

Vlera e ndihmës gjithsej për SME-të është 66.91 milionë lekë e ndarë në:

- Fondi i Ekonomisë kreative në vlerën 9.978.321 lekë;
- Fondi i Konkurrueshmërisë në vlerën 32.976.822 lekë;
- Fondi *Start-up* në vlerën 9.151.378 lekë;
- Fondi i Inovacionit në vlerën 14.810.000 milionë lekë.

Bashkia e Tiranës vlera e ndihmës gjithsej për SME-të është 19.8 milionë lekë, e ndarë në:

- Plani i ndihmës shtetërore për fuqizimin e grave dhe nxitjen e sipërmarrjes në vlerën 10 milionë lekë;
- Plani i ndihmës shtetërore për nxitjen e punësimit të biznesit rinor në vlerën 8 milionë lekë;
- Plani i ndihmës shtetërore për të rinj dhe të reja drejt një profesioni në vlerën 1.806.995 lekë.

3.2.2 Ndihma shtetërore sektoriale

Në vitin 2019 ndihma shtetërore sektoriale në vlerë absolute është 4, 272.8 mln lekë (34.72 mln euro). Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2019 është 40.8 %.

Tabelë nr. 5. Ndihma shtetërore sektoriale 2014–2019

Ndihma sektoriale	2014		2015		2016		2017		2018		2019	
	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR
Transport publik	440.00	3.14	440.00	3.20	390.00	2.88	400.00	3.00	400.00	3.14	400.00	3.25
Shërbimi publik	450.00	3.21	430.00	3.12	428.70	3.17	974.90	7.32	1,000.00	7.84	400.00	3.25
Minierat	29.00	3.21	36.95	0.27	39.35	0.29	35.00	0.26	68.80	0.54	25.64	0.21
Infrastruktura		-	-	-	-	-	-	-	-	-	491.96	4.00
Turizmi	-	-	-	-	33.65	0.25	8.89	0.07	-	-	2,954.41	24.02
TOTALI	**919.00**	**9.56**	**906.95**	**6.59**	**891.70**	**6.59**	**1,418.79**	**10.65**	**1,468.80**	**11.51**	**4,272.00**	**34.73**

Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE

Grafik nr. 7. Ecuria e ndihmës shtetërore sektoriale 2014–2019

Grafik nr. 8. Struktura e ndihmës shtetërore sektoriale 2019



Në strukturën e ndihmës sektoriale (vertikale) për vitin 2019, peshën kryesore e zë ndihma për shërbimet publike (ndihma për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve), duke vijuar me ndihmën për transportin publik (hekurudha) dhe ndihmën për minierat (në mbyllje dhe konservim).

Ndihma për transportin publik, e dhënë nga buxheti i shtetit për mbështetjen e transportit hekurudhor, është 400 milionë lekë edhe në vitin 2019.

Ndihma për shërbimet publike: në vitin 2019 ndihma për shërbimet publike është në formën e subvencionit nga buxheti i shtetit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve në shumën 400 milionë lekë.

Ndihma për minierat: ndihma për minierat nga buxheti i shtetit për vitin 2019 jepet për vazhdimin e mbylljes së minierave të shfrytëzuara dhe joefektive, privatizimi i aseteve për të mundësuar monitorimin e fenomeneve të post shfrytëzimit në shumën 25.64 milionë lekë.

Ndihma për infrastruktura/Broadband: në bazë të vendimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 89, datë 23.4.2019 "Autorizimi i ndihmës shtetërore për dixhital-dividenti", Autoriteti i Mediave Audiovizive në cilësinë e dhënësit të ndihmës shtetërore ka dhënë ndihmën në vlerën 4 milionë euro (491.96 mln lekë). Përfitues të

skemës janë operatorët historikë kombëtarë, si edhe operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike.

Ndihma për turizmin: ndihma për sektorin e turizmit nga buxheti i shtetit për vitin 2019 është përfituar nga strukturat akomoduese nga reduktimi i TVSH-se nga 20% në 6% për vitin 2019, më përfitues gjithsej 2,527 subjekte në shumën 2,954,407,314 lekë.

Subjektet që kanë përfituar statusin e veçantë "Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special", dhe kanë nënshkruar Marrëveshje Zhvillimi me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për vitin 2019, janë si më poshtë:

1. "Tirana Business Park" sh.p.k.

- VKM nr. 153, datë 20.3.2019 "Për dhënien e statusit të veçantë 'Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special', aplikuesit 'Tirana Business Park' sh.p.k.".

- Nënshkruar marrëveshje zhvillimi me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, datë 30.4.2019.

2. "Concord Investment" sh.p.k.

- VKM-ja nr. 300, datë 10.5.2019 "Për dhënien e statusit të veçantë 'Investitor në strukturë Akomoduese me 5 yje, status special', aplikuesit 'Concord investment' sh.p.k.".

- Nënshkruar marrëveshje zhvillimi me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, datë 12.6.2019.

IV. INSTRUMENTET E SHPËRNDARJES SË NDIHMËS SHTETËRORE

Ndihma shtetërore e dhënë nga burime shtetërore, në varësi të llojit (instrumentit) të përdorur, përbën një shpenzim real apo potencial të pasurisë publike duke pasur një efekt në mbledhjen e të ardhurave publike. Në vitin 2019, ndihma shtetërore është dhënë kryesisht në formën e subvencioneve dhe incentivave fiskale. Referuar metodologjisë së përdorur nga BE-ja, instrumentet e ndihmës shtetërore klasifikohen në:

A1 – subvencione dhe grante;

A2 – përjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale;

B – pjesëmarrja në kapital;

C1 – hua të buta;

C2 – instrumente të tjera;

D – garancitë.

Tabelë nr. 6. Ndihma shtetërore gjithsej sipas instrumenteve

Kategoria e ndihmës	Subvencione dhe Grante (A1)	Përjashtim nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale (A2)
Ndihma Horizontale		
Punësimi	247.73	
Trajnim	98.22	
Sport	121.72	
Kultura	63.32	
Ndihma operacionale		1,532.50
Kerkim, zhvillim dhe inovacion		2,060.24
SME	86.71	
Ndihma Sektoriale		
Transport publik (Hekurudha)	400.00	
Shërbimi publik	400.00	
Minierat	25.64	
Infrastruktura Broadband	491.96	
Turizmi		2,954.41
TOTALI	**1,935.30**	**6,547.15**

Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE

Instrumenti i përdor më shumë është A2 – përjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet social, sikurse paraqitet edhe në grafikun nr. 8.

Grafik nr. 9. Struktura e shpërndarjes të instrumenteve të ndihmës shtetërore për vitin 2019



VENDIM
Nr. 535, datë 8.7.2020

PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËVE PUBLIKE NË KOMUNITET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet.

2. Programi i punëve publike në komunitet është një program 12-mujor, i cili ka qëllim përfshirjen në tregun e punës të punëkërkuesve të papunë afatgjatë nëpërmjet ofrimit të mundësive të trajnimit dhe të punësimit me kohë të pjesshme në aktivitete me fokus shërbimet në dobi të komunitetit.

3. Fushat e veprimtarisë së programit të punëve publike në komunitet përfshijnë:

a) shërbimet e kujdesit për fëmijët;

b) shërbime të kujdesit shëndetësor dhe social;

c) shërbime të rehabilitimit të ish-përdoruesve të substancave narkotike;

ç) punime dhe shërbime për komunitetin dhe mjedisin;

d) shërbime këshillimi dhe informacioni;

dh) shërbime rinore;

e) sport;

ë) art, turizëm dhe kulturë.

II. PROGRAMI

1. Programi i punëve publike në komunitet zbatohet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, më poshtë AKPA, në bashkëpunim me organizatat e përcaktuara në pikën 5, të kreut III, të këtij vendimi, nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e kësaj Agjencie, përfshirë aspektet financiare, ato të menaxhimit dhe të trajnimit.

2. Kohëzgjatja e mbështetjes së ofruar nga ky program është 12 muaj.

3. Punëkërkuesit e papunë, pjesëmarrës në këtë program, angazhohen 20 orë në javë, gjatë 5 (pesë) ditëve të javës. Pjesën tjetër të ditës së punës punëkërkuesit e papunë pjesëmarrës mund të angazhohen në trajnime shtesë. Trajnimi kryhet në qendrat publike të formimit profesional ose në ato private të licencuara.

4. Në dispozicion të punëkërkuesve të papunë, pjesëmarrës në këtë program, vihet një mbikëqyrës, sipas pikës 9, të kreut III, të këtij vendimi, i cili është përgjegjës për zhvillimin e planit individual të trajnimit (PIT) për çdo person të punësuar në projekt dhe për garantimin e zbatimit të këtij programi.

5. PIT-ja mund të përfshijë trajnime më të avancuara ose të specializuara të aftësive apo dhe mund të ofrohet si mbështetje për njohuritë bazë të shkrimit dhe të leximit. Ndërsa një pjesë e trajnimit duhet të trajtojë një gamë të gjerë temash që lidhen me jetën dhe me punën për një orientim më të mirë në tregun e punës.

6. PIT-ja miratohet nga strukturat përkatëse të AKPA-së.

III. KRITERET E APLIKIMIT

1. Punëkërkuesit me të drejtë përfitimi janë të gjithë punëkërkuesit e papunë të regjistruar dhe aktivë, për jo më pak se 12 muaj në zyrën e punës, të moshës mbi 25 vjeç, pasi të kenë marrë shërbimet e nevojshme të punësimit, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, nga specialisti përkatës i punësimit. Nevojat dhe profili i punëkërkuesit duhet të përshtaten me kërkesat për aftësi të vendit të punës që siguron programi për ta.

2. Punëkërkuesit, pjesëmarrës në këtë program, në rast largimi, mund të zëvendësohen vetëm gjatë tremujorit të parë të programit.

3. Një punëkërkues mund të marrë pjesë vetëm një herë në këtë program, brenda një periudhe pesëvjeçare.

4. Punëdhënësit, të regjistruar në zyrën e punës, me të drejtë përfitimi në këtë program, janë:

a) organizata jofitimprurëse;

b) organizata të shoqërisë civile;

c) biznese sociale/sipërmarrje sociale/ndërmarrje sociale;

ç) institucione publike.

5. Punëdhënësit duhet të jenë të specializuar në fushat e përcaktuara në pikën 3, të kreut I, të këtij vendimi, të cilët zbatojnë projekte me interes publik, në nivel vendor dhe në favor të komunitetit, të cilët kanë kapacitetet dhe eksperiencën e duhur për zbatimin e këtyre projekteve.

6. Punëdhënësit, sipas pikës 4, të kreut III, të këtij vendimi, duhet të jenë të regjistruar sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe të kryejnë aktivitete në përputhje me qëllimin e përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

7. Punëdhënësit, sipas pikës 4, të kreut III, të këtij vendimi, duhet të kenë shlyer detyrimet tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Punëdhënësit, pjesëmarrës në këtë program, mbartin të gjitha përgjegjësitë dhe detyrimet e mbikëqyrjes dhe të punësimit, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Punëdhënësit kanë të drejtë të aplikojnë për maksimumi dy grupe, me numër jo më të madh se 7 (shtatë) punëkërkues të papunë secili grup.

10. Punëdhënësi ka për detyrë të punësojë një mbikëqyrës për çdo grup përfituesish, nga 1 në 14 pjesëmarrës, i cili mund të punojë deri në 40 orë në javë.

11. Në rast largimi të mbikëqyrësit, punëdhënësi është i detyruar ta zëvendësojë atë duke njoftuar në AKPA dhe, kjo e fundit, të japë miratimin. Në rast të kundërt, duhet të kthejë 100% të subvencioneve të përfituara për pjesën e punëdhënësit.

12. Mbikëqyrësi ka për detyrë të ndjekë me përpikëri mbikëqyrjen e punëkërkuesve, pjesëmarrës në program, sipas kushteve të kontratës për zbatimin e projektit, lidhur ndërmjet punëdhënësit, punëmarrësit dhe AKPA-së.

IV. MBËSHTETJA E PËRFITUESVE

1. Punëdhënësi përfitues, sipas pikës 4, të kreut III, të këtij vendimi, përfiton një grant për të financuar shpenzimet.

2. Për punëkërkuesit e papunë, pjesëmarrës në program, financimet janë, si më poshtë vijon:

a) Financim i pagës në shumën 50% të pagës minimale, në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

b) Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit.

c) Kupon për trajnim të punëkërkuesve të papunë, pjesëmarrës në program, deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë, në rastet kur trajnimet e miratuara nuk ofrohen nga ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional.

ç) Për përfituesit jetimë që përfitojnë nga ky status edhe pasi kanë kaluar moshën 25 vjeç, sipas legjislacionit në fuqi, prindër të vetëm me fëmijë nën 6 vjeç, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit, viktimat e dhunës në familje ose të dhunës me bazë gjinore, përfitues të ndihmës ekonomike, romë dhe egjiptianë mbulohen edhe shpenzime të tjera, si më poshtë vijon:

i. bonus për shpenzimet e transportit mbulohen për të gjitha kategoritë e mësipërme, të cilët e kanë vendbanimin mbi 2 km nga vendi i punës, në vlerën prej 1 600 (një mijë e gjashtëqind) lekësh në muaj;

ii. për prindërit e vetëm me fëmijë nën gjashtë vjeç, jepet bonus në vlerën prej 3 000 (tre mijë) lekësh në muaj, për ndjekjen e kopshteve dhe të çerdheve, për çdo fëmijë në ngarkim;

iii. financim deri në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë për një person, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë, nëse punëson më shumë se dy persona, për përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës, për personat me aftësi të kufizuara.

3. Për punëdhënësin, pjesëmarrës në program, financimet janë, si më poshtë vijon:

a) Për mbikëqyrësin, financim të pagës në shumën:

i. 50% të pagës mesatare në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për grupin nga 1–7 punëkërkues të papunë pjesëmarrës, për 20 orë në javë;

ii. 100% të pagës mesatare në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për grupin nga 1–14 punëkërkues të papunë pjesëmarrës, për 40 orë në javë.

b) Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës mesatare në shkallë vendi, të ofruara gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit.

c) Tarifë për mbulimin e shpenzimeve materiale, të nevojshme për zbatimin e projekteve të punësimit në komunitet, në shumën totale deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo përfitues, këto të justifikuara me fatura tatimore, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Granti disbursohet në këste. Kësti i parë prej 20% jepet pas nënshkrimit të kontratës për të mbuluar shpenzimet e para të projektit dhe, në vijim, çdo muaj, pas vërtetimit të shpenzimeve.

V. RREGULLAT DHE PROCEDURAT E ZBATIMIT

1. AKPA-ja, nëpërmjet strukturave të saj, publikon informacionin e nevojshëm në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në platforma të tjera (faqe interneti, media sociale, shtyp) në lidhje me zbatimin e programit dhe informon rregullisht punëdhënësit dhe punëkërkuesit e regjistruar.

2. Në fillim të çdo shpalljeje për aplikim, AKPA-ja harton dhe publikon termat e referencës, së bashku me kriteret e aplikimit dhe të vlerësimit sipas këtij vendimi, fushat dhe vlerat e financimit, si dhe afatet dhe procedurën e aplikimit. AKPA-ja, në varësi të programit që do të financohet, përcakton dhe miraton kritere të veçanta, të cilat përfshihen në dokumentet e konkurrimit dhe shpallen publikisht.

3. Punëdhënësit mund të aplikojnë për përfshirjen në program, në rrugë elektronike apo fizikisht në zyrën përkatëse të punësimit të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) formularin e aplikimit të plotësuar, sipas modelit standard të miratuar dhe të publikuar nga AKPA-ja;

b) autorizimin e punëdhënësit, me të cilin autorizohet AKPA-ja për të kryer të gjitha verifikimet dhe kërkimet e nevojshme të dokumenteve dhe të të dhënave të aplikimit;

c) vetëdeklarim mbi mospasjen në ngarkim të punëdhënësit të shkeljeve apo të sanksioneve që lidhen me legjislacionin e punës, gjatë dy viteve të fundit;

ç) vendimin e regjistrimit nga gjykata e rrethit gjyqësor, origjinal ose fotokopje e noterizuar (vetëm organizatat);

d) kopje të statutit të organizatës, origjinal ose fotokopje e noterizuar (vetëm organizatat);

dh) kopje e noterizuar e NIPT-it (vetëm organizatat);

e) licencë/leje të vlefshme për ushtrim veprimtarie, origjinal ose fotokopje e noterizuar, nëse veprimtaritë e kërkuara për t'u financuar nuk mund të kryhen, sipas ligjit, pa zotëruar një licencë të akorduar nga autoritetet publike.

4. Pas marrjes së aplikimit nga punëdhënësi, struktura rajonale e punësimit kryen verifikimet e përmbushjes së kritereve të punëdhënësit, nëpërmjet dokumenteve të paraqitura dhe nxjerr nga sistemi ekstraktin historik të punëdhënësit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (për bizneset sociale/sipërmarrjet sociale/ndërmarrjet sociale), si dhe vërtetimin për pagimin e detyrimeve tatimore, ku konfirmon se nuk ka detyrime tatimore.

5. Struktura rajonale e punësimit, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga momenti i aplikimit, verifikon plotësimin e kushteve formale paraprake të aplikimit dhe përputhshmërinë e tij me rregullat e zbatueshme të programit. Në rast të mosplotësimit të kushteve paraprake, struktura rajonale e punësimit i kërkon aplikuesit plotësimin e dokumentacionit.

6. Në rast të plotësimit të kushteve paraprake, në bashkëpunim me strukturën vendore të punësimit dhe punëdhënësin, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga momenti i plotësimit të dokumentacionit, hartohet lista e pjesëmarrësve punëkërkues të papunë në program, dhe projekti paraqitet në Komisionin e Miratimit të Programeve të Nxitjes së Punësimit. Komisioni ka detyrën e vlerësimit të secilit aplikim, brenda 5 (pesë) ditëve pune, me qëllim miratimin ose refuzimin e tij, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

a) projektet duhet të jenë jo për qëllime komerciale dhe fitimi;

b) punëdhënësit kanë kapacitetin e ofrimit të një programi trajnimi të mirëorganizuar dhe me variacion për të gjithë pjesëmarrësit;

c) punëdhënësit kanë kapacitet për të ofruar përvojë pune ose aftësi, të cilat mund të transferohen në tregun e hapur të punës dhe të mbështesë personin e papunë drejt një progresi më të lehtë;

ç) punëdhënësit kanë kapacitet për të ofruar zhvillim dhe trajnim për pjesëmarrësit, të orientuar veçanërisht drejt rritjes së gatishmërisë

së pjesëmarrësve, për të marrë pjesë në tregun e hapur të punës, me objektiva të qartë dhe mbështetje për progres;

d) punëdhënësit kanë kapacitet për ta administruar projektin me sukses, për sa u përket financave, regjistrave financiarë dhe jofinanciarë, detyrimeve ligjore etj.;

dh) programi i punës së punëdhënësve nuk duhet të ketë pjesë të tij asnjë promovim/advokim të:

i. një partie specifike politike ose të politikave të një partie specifike politike;

ii. një besimi specifik fetar ose kishe, përveçse nëse kufizohet qartësisht tek anëtarët/ithtarët e asaj kishe/atij besimi;

iii. ndonjë kulti (laik ose fetar);

7. Struktura rajonale e punësimit i komunikon punëdhënësit aplikues përgjigjen përfundimtare mbi pranimin apo refuzimin e aplikimit, brenda 2 (dy) ditëve pune.

8. Punëdhënësi dhe punëkërkuesi i papunë, në cilësinë e punëmarrësit, lidhin një kontratë pune, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë, në përputhje me programin. Një kopje e kontratës së punësimit mbahet në strukturën rajonale të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, i cili monitoron zbatimin e saj deri në përfundim të projektit.

9. Pas nënshkrimit të kontratës së punës, sipas pikës 8, të kreut V, të këtij vendimi, ndërmjet strukturës rajonale, punëdhënësit dhe punëkërkuesit të papunë pjesëmarrës në program, nënshkruhet marrëveshja trepalëshe për zbatimin e programit.

10. Për pjesëmarrësit në program, të cilët kanë qenë përfitues të ndihmës ekonomike, struktura vendore informon institucionin përgjegjës për shërbimin social.

11. Nëse punëdhënësi zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën me përfituesin, punëdhënësi është i detyruar të kthejë 100% të mbështetjes financiare të përfituar deri në atë moment, për rastet e zgjidhjes së kontratës për shkaqe të paarsyeshme ose të pajustifikuara.

12. Nëse punëdhënësi nuk respekton marrëveshjen trepalëshe për zbatimin e programit, ai përjashtohet nga pjesëmarrja në program për një periudhë katërvjeçare.

13. Financimi i punëdhënësit do të bëhet në formë rimbursimi, pas verifikimit nga strukturat përkatëse të punësimit të kryerjes së pagesës nga ana e tij.

14. Monitorimi i zbatimit kryhet nga strukturat përkatëse të punësimit.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit përcakton çdo vit prioritetet për programet e nxitjes së punësimit sipas zonave gjeografike, sektorëve ekonomikë dhe nevojave të punëkërkuesve dhe miraton planin e zbatimit të fondeve të nxitjes së punësimit, pas propozimit nga Drejtoria e Përgjithshme e AKPA-së.

2. AKPA-ja përgatit raportin vjetor brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe ia paraqet ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe strukturës përgjegjëse të ndihmës shtetërore.

3. AKPA-ja ruan të dhënat për programet 10 (dhjetë) vjet, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Vlerësimi i ndikimit të programeve kryhet çdo katër vjet nga ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, nëpërmjet ekspertëve ose organizatave me përvojë në këtë fushë.

5. Afati i zbatimit të programit është 5 (pesë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

6. Ngarkohet drejtori i Përgjithshëm i AKPA-së për miratimin e rregullores së zbatimit të programit, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i shtetit, zëri "Nxitja e punësimit".

8. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 536, datë 8.7.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 47, DATË 22.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2020, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 47, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet 2 278 (dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë) veta.

2. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 1, në ndarjet "Gr. 05, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural", "Gr. 10, Ministria e Financave dhe Ekonomisë", "Gr. 14, Ministria e Drejtësisë", "Gr. 15, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme" dhe "Gr. 87, Institucione të tjera qeveritare", shtohen nënndarjet sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Në ndarjen "Gr. 05, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural" periudha kohore për 2 punonjësit manovratorë dhe 3 punëtorë të mirëmbajtjes së zgarës së Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Durrës bëhet 6-mujore.

II. Ngarkohen institucionet e përmendura në këtë vendim që të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë detajimin e numrit të punonjësve me kontratë, periudhën kohore të punësimit dhe kategorinë përkatëse të pagës së tyre.

III. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Gr.	Emri i Institucionit		Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
5	**Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**	1			
	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë	1	Specialist	8 orë/ditë	5 muaj
10	**Ministria e Financave dhe Ekonomisë**	6			
	Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut	5	Operatorë	8 orë/ditë	6 muaj
	Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut	1	Specialist	8 orë/ditë	6 muaj
14	**Ministria e Drejtësisë**	1			
	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	1	Sanitare	8 orë/ditë	6 muaj
15	**Ministria Për Evropën dhe Punët e Jashtme**	3			
	Aparati	3	Specialist	8 orë/ditë	6 muaj
87	**Institucione te tjera qeveritare**	2			
	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	2	Specialist	8 orë/dite	6 muaj
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	13			

VENDIM
Nr. 542, datë 8.7.2020

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT E TË PROCEDURËS PËR PAJISJEN, REFUZIMIN DHE ANULIMIN E LEJES SË PUNËS, PËR TË TRANSFERUARIT BRENDA NDËRMARRJES, TË TIPIT "A/TN"[3]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 71, pika 8, 86, pika 2, e 105, pika 1, të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të huajit i jepet leje pune e tipit "A/TN", si i transferuar brenda ndërmarrjes/shoqërisë, nëse plotëson kriteret, si më poshtë vijon:

a) ka një marrëdhënie pune me shoqërinë tregtare që e transferon përkohësisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 89, të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar, të paktën për një periudhë

6-mujore, të pandërprerë për "administrator" dhe "specialist', si dhe 3-mujore të pandërprerë për "praktikant të diplomuar", që paraprin menjëherë këtë transferim;

b) ka kualifikimin profesional dhe përvojën e nevojshme në shoqërinë tregtare/degën e shoqërisë së huaj, në të cilën ai ose ajo do të transferohet si administrator ose specialist, ose në rastin e një "praktikanti të diplomuar", gradën universitare të kërkuar;

c) kryen detyrat, ka njohuritë dhe plotëson kushtet sipas përcaktimeve të dhëna në nenet 3 e 89, të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar;

ç) ka hyrë në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rastin kur kërkesa paraqitet nga vetë i huaji në zyrën e punës;

d) paraqet një dokument të vlefshëm udhëtimi, sipas përcaktimeve në ligjin për të huajt në Republikën e Shqipërisë;

dh) paraqet dokumentacionin përkatës që vërteton se dega ose zyra e përfaqësimit dhe shoqëria tregtare e themeluar në një vend jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë i përkasin të njëjtës shoqëri tregtare ose grupi shoqërish;

e) vërteton se në fund të periudhës së transferimit do të transferohet në një degë që i përket shoqërisë tregtare ose grupit të shoqërive të vendosura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

ë) përmbush kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë për të ushtruar profesionin e rregulluar;

f) ka paraqitur kërkesë për t'u siguruar në skemat e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

g) deklaron vendbanimin në territorin e Republikës së Shqipërisë të punëmarrësit të huaj të transferuar, në përputhje me ligjin "Për gjendjen civile".

2. Kërkesa për t'u pajisur me leje pune të tipit "A/TN" bëhet nga:

a) i huaji;

b) punëdhënësi, pranë të cilit i huaji transferohet brenda ndërmarrjes/shoqërisë.

3. Personat e përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën e të huajit me të dhënat personale, sipas formatit të dhënë në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) kopjen e aktit të njohjes së personalitetit juridik të ndërmarrjes/shoqërisë mëmë, të përkthyer në gjuhën shqipe, të vërtetuar;

c) kopjen e kontratës së punës, të lidhur me shoqërinë tregtare mëmë, ku të vërtetohet se ka një periudhë pune jo më pak se 6 muaj të pandërprerë për "administrator" dhe "specialist", si dhe 3-mujore të pandërprerë për "praktikant të diplomuar", në këtë shoqëri tregtare, të përkthyer në gjuhën shqipe, të vërtetuar;

ç) deklaratën e transferimit brenda shoqërisë nga punëdhënësi i huaj, sipas nenit 90, të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar;

[3] Ky vendim është përafruar pjesërisht me direktivën 2014/66/BE, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të 15 majit 2014, mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në kuadër të transferimit brenda ndërmarrjes. Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian L 157/1, datë 27.5.2014.

d) certifikatën dhe dëshminë për njohuritë e specializuara, të përkthyera në gjuhën shqipe, të vërtetuar;

dh) kopjen e pasaportës;

e) tri fotografi;

ë) dokumentacionin përkatës, sipas ligjit kombëtar për ushtrimin e profesioneve të rregulluara, në rast se aktiviteti që do të ushtrojë shtetasi i huaj është një profesion i rregulluar;

f) kërkesën e paraqitur në institucionet përkatëse për t'u siguruar në skemat e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

g) kontratën e qirasë (kopje) ose dokument ekuivalent me të, që tregon adresën e banimit në territorin e Republikës së Shqipërisë të punëmarrësit të huaj të transferuar;

gj) dokumentacionin që vërteton pagesën e tarifës së përcaktuar në pikën 13, të këtij vendimi.

4. Personat e përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, aplikojnë *on-line* përmes shërbimit elektronik në portalin qeveritar *e-Albania*, duke paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi.

5. Kërkesa dhe dokumentacioni i përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi, i drejtohet zyrës përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës subjekti, pranë të cilit do të transferohet, ushtron veprimtarinë ekonomike, dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive në nivel qendror, nëse subjekti, pranë të cilit do të transferohet, e ushtron veprimtarinë ekonomike në më shumë se një rajon gjeografik.

6. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive/zyra përkatëse e punësimit, kur vlerëson se dokumentacioni është i plotë, pajis të huajin, me leje pune të tipit "A/TN", brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar, sipas formatit të dhënë në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive/zyra përkatëse e punësimit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e aplikimit, shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe nëse vlerëson se ai nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 3, të këtij vendimi, i kërkon të huajit plotësimin e tij, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

8. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive/zyra përkatëse e punësimit ia kthen kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur të huajit, nëse ai nuk e ka plotësuar atë brenda afatit të përcaktuar në pikën 7, të këtij vendimi.

9. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive/zyra përkatëse e punësimit, pas paraqitjes së kërkesës nga personat e përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, verifikon shlyerjen e detyrimeve lidhur me pagat e punonjësve, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga ana e punëdhënësit, pranë të cilit do të punësohet i huaji.

10. Të huajit i refuzohet lëshimi i lejes së punës të tipit "A/TN", kur dokumentacioni nuk është i plotë edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 7, të këtij vendimi, dhe/ose nëse vërtetohet njëra nga situatat e përcaktuara në nenin 77, të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar.

11. I huaji, të cilit i refuzohet ose i anulohet leja e punës e tipit "A/TN", ka të drejtën e ankimimit, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 2, të nenit 81, të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar.

12. Leja e punës e tipit "A/TN" përfundon, nëse plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 78, të ligjit nr. 108/2013, "Për të huajt", të ndryshuar.

13. I huaji, i cili pajiset për herë të parë me leje pune të tipit "A/TN", para marrjes së lejes së punës, detyrohet të paguajë tarifën prej 6 000 (gjashtë mijë) lekësh.

14. Drejtoria, që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit, në ministrinë e përgjegjëse që mbulon çështjet e punësimit, monitoron, në mënyrë periodike, procedurën e ndjekur nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe zyrat përkatëse të punësimit për dhënien e lejes së punës.

15. Vendimi nr. 85, datë 12.2.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës të tipit 'A/TN'", shfuqizohet.

16. Ngarkohen ministria përgjegjëse që mbulon çështjet e punësimit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe zyrat përkatëse të punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKS 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

REPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRY OF FINANCE AND ECONOMY

DREJTUAR: AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
TO: NATIONAL AGENCY OF EMPLOYMENT AND SKILLS_____

ZYRËS SË PUNËSIMIT
EMPLOYMENT OFFICE _____

FORMULAR-KËRKESË / APPLICATION
për lëshimin e lejes së punës një të huaji/for issuance of work permit to a foreigner

1. TË DHËNAT E PUNËDHËNËSIT/INFORMATION ABOUT THE EMPLOYER

1. Emri i punëdhënësit_____
Name of the employer

2. Vendi dhe adresa e punëdhënësit_____
Seat and address of the employer

3. Numri i regjistrimit në ISSH | ___ | _ | _ | _ | _ | _ | _ | _ | _ | _ |
Registration number in the Cr Health Insurance Institute

4. Kodi fiskal NIPT | _ | _ | _ | _ | _ | _____ | *OIB* | _ | _ | _ | _ | _ | _ | _ | _ | _ | _____ | _ | _ |
Business activity code

a) Vendimi i gjykatës për njohjen e biznesit ose:
Court Decision on Business Acknowledgment or

b) Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Biznesit:_____
Abstract from National Biznes Centre

5. Data e menduar e fillimit dhe e përfundimit të punës | ___ | _ | _ | _ | _ | _ | _ | _ | _ | deri në
| ___ | _ | _ | _ | _ | _ | _ | _ | _ |
Period for which the work permit is requested from to

6. Emërtimi i vendit të punës_____
Name of the job position

7. Kuotat vjetore ***PO JO***
Yearly quota ***YES NO***

8. Punësimi sezonal ***PO JO***
Seasonal employment ***YES NO***

9. Migrimi ditor ***PO JO***
Daily migration ***YES NO***

2. TË DHËNAT E TË HUAJIT/INFORMATION ABOUT THE FOREIGNER

1. Mbiemri _____
Surname

2. Emri _____
Given name(s)

3. Emri i babait _____
Name of the parent

4. Datëlindja ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙
Date of birth

5. Gjinia **F M** ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙
Sex ***M F**** to be entered if issued

6. Vendi dhe shteti i lindjes_____
Place and country of birth

7. Shtetësia_____
Nationality

8. Adresa e banimit në Shqipëri_____
Residential address in the Republic of Albania

9. Kodi dhe emri i punësimit ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _____ ❙ _
Code and name of occupation

10. Kualifikimet ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙
Skill qualifications

11. Aktivitet fitimprurës ***PO JO***
Gainfully employed ***YES NO***

3. DOKUMENTI I VLEFSHËM / VALID DOCUMENT

1. Lloji i dokumentit _____
Type of document

2. Numri ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙
Number

3. Lëshuar në ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙
Issued on

4. E vlefshme deri më ❙ ____ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙ _ ❙
Valid until

5. Autoriteti kompetent _____
Competent authority

6. Lëshuar nga _____
Place and country of issuance

_____ _____
Vendi dhe data Emri / mbiemri i aplikantit
(Place and date) (Applicant)

ANEKS 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nr.__prot. Datë ……

LEJE PUNE PËR TË HUAJT
TIPI: A/TN

Në zbatim të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013, "Për të huajt", të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. ...., datë ___.___.2020, "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës, për të transferuarit brenda ndërmarrjes, të tipit "A/TN",

Z./znj.
Mr/Ms (emri, mbiemri / Given name(s)
Surname)

FOTOGRAFIA / PHOTO

Lindur më
_____Born on(data, muaji, viti / Day Month Year)

Në _____
In (vendlindja / Place and country of birth)

Gjendja civile _____
(Civil Status)

Me shtetësi _____
Nationality

Me profesion _____
Skill qualifications

Lloji i dokumentit dhe numri _____ | _ | _ | _ | _ | _ | _ | _ | _ | _ | _ | _ |

Type of document and number

I huaji pajiset me leje pune të tipit A/TN, pasi përfshihet në kategorinë e përcaktuar në nenin 89, të ligjit nr.108/2013, datë 28.3.2013, "Për të huajt", të ndryshuar.

Për të ushtruar aktivitetin / veprimtarinë e tij/saj: Name of the employer

Statusi i subjektit: _____

(Subject's Legal Status)

Sektori i aktivitetit: (Sector of Activity)

Me adresë: _____
Seat and address

Vlefshmëria e lejes: (Work Permit Validity)

Data e lëshimit: (Issuance Date)

Data e skadimit: (Expiration Date)

Pagesa: (Application Fee)

Kjo leje pune është e vlefshme derisa i huaji të vazhdojë të bëjë pjesë në këtë kategori punësimi, bazuar në ligjin nr. 108/2013, datë 28.3.2013, "Për të huajt", të ndryshuar.

Institucioni lëshues: _____ (Issuing Authority)

VENDIM
Nr. 543, datë 9.7.2020

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR BLERJEN E APARTAMENTEVE, QË DO T'IU DHUROHEN FAMILJARËVE TË VIKTIMAVE SI PASOJË E TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019, NGA BASHKIA KAMZË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 18, pika 2, dhe 24, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"; të aktit normativ nr. 6, datë 30.11.2019, të Këshillit Ministrave, "Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 18 263 702 (tetëmbëdhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e dy) lekë, për blerjen e 5 (pesë) apartamenteve, që do t'iu dhurohen familjeve të viktimave si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019, nga Bashkia Kamzë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi i rindërtimit, pjesa e financuar nga buxheti i shtetit, i miratuar për vitin 2020, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 10, datë 9.7.2020

PËR MËNYRËN E MARRJES SË MOSTRAVE, PËR NDRYSHIMIN E KATEGORISË SË RESURSIT NGA TOKË E PAFRYTSHME DHE TOKË URBANE TRUALL, NË TOKË BUJQËSORE DHE KRYERJEN E ANALIZAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; kreu IV, pika 1 dhe 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 410, datë 27.9.2012, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës"; të pikës 7, të kreut V, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 121, datë 17.2.2011, "Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga Drejtoritë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë ose bashki",

UDHËZOJ:

I. Shqyrtimi i kërkesave për ndryshim të kategorive të tokës së pafrytshme dhe tokë urbane, truall, në tokë bujqësore, bëhet si më poshtë:

1. Kërkesat nga subjektet e interesuara paraqiten në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë dhe përmbajnë:

a) dokumentin e pronësisë, kartelën e pasurisë së paluajtshme, shoqëruar me hartën kadastrale ose planin e rilevimit, të përgatitur sipas standardit të miratuar nga një ekspert topograf i licencuar, ku të përcaktohen qartë kufijtë e pronës. Kur subjekti është institucion shtetëror dhe e ka tokën në administrim, paraqet aktin mbi të cilin e ka marrë në përgjegjësi administrimi ose në përdorim;

b) vërtetimin për gjendjen e resursit, lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, e qarkut.

2. Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë i njofton subjektit tarifat që paguhen për shpenzimet e marrjes së mostrave në terren dhe tarifën për kryerjen e shërbimit nga ky institucion. Subjekti lidh aktmarrëveshje dhe kryen pagesën në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë, sipas tarifave të miratuara.

3. Pas kryerjes së pagesave, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë, ngre grupin e punës, i cili merr mostra në terren dhe kryen procedurën e analizave dhe përgatitjen e raportit. Marrja e mostrave në terren merret në përputhje me këtë udhëzim.

Grupi i punës:

a) verifikon nëse toka është e përshtatshme për studimin fushor dhe nëse janë larguar të gjitha materialet inerte, të cilat pengojnë kryerjen e studimit fushor dhe marrjen e mostrave;

b) kryen studimin fushor të ngastrës/parcelës bazuar në metodikën tip të studimit të bonitetit të tokave;

c) vendos, në raport me situatën faktike, numrin e profileve dhe treguesve pedelogjikë dhe numrin e mostrave përfaqësuese për përcaktimin e treguesve agrokimikë, për çdo parcelë. Profili i tokës hapet në raportin 1 profil në 1000 metër katror tokë dhe merren 5 mostra ndihmëse në rastin e tokës truall dhe urbane;

ç) thellësia e profilit si rregull është 100 cm dhe në rast se janë zhvilluar aktivitete industriale apo urbane të cilat mund të kenë shkaktuar ndotje, subjekti duhet të largojë shtresën aktive deri në 50 cm. Në këtë rast toka do t'i nënshtrohet dhe analizave për metale të rënda, niveli i të cilave duhet të jetë poshtë limiteve të vendosura nga Bashkimi Evropian (BE);

d) grupi i ekspertëve, në parcelën objekt i kryerjes së analizave për ndryshim të kategorisë së tokës, sipas bonitetit, përgatit skemat e vendhapjes së profileve për vlerësimin e treguesve pedelogjikë dhe të vendmarrjes së mostrave ndihmëse, për krijimin e mostrës përfaqësuese, për vlerësimin e treguesve agrokimikë. Skemat përgatiten përkatësisht sipas lidhjes nr. 1 dhe lidhjes nr. 2, të këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

dh) në skemat që përgatiten të paraqitet:

- forma gjeometrike reale e parcelës në shkallën 1÷1000 ose 100 cm^2 në hartë baras (=) me 10000 m^2 në natyrë (terren). Në anën e majtë të skemës paraqitet kufiri koordinativ (V dhe L) i vendndodhjes së parcelës;

- pavarësisht nga forma gjeometrike e parcelës, nëpërmjet matjeve me saktësi,

përcaktohet dhe shënohet në skemë diagonalja më e gjatë e saj. Matja e gjatësisë së diagonales fillon në hyrje të parcelës, pika "0" dhe mbaron në fund të saj, pika "N";

- vendhapja e profilit për vlerësimin e treguesve pedelogjikë bëhet në mesin e diagonales më të gjatë, që matet dhe pasqyrohet me saktësi në skemë. Matja fillon nga pika "1" e saj. Vendhapja e profilit regjistrohet me sistemin e pozicionimit gjeografik (GPS), si dhe shënohen koordinatat (V dhe L) të marra nga GPS-ja;

- marrja e mostrave ndihmëse për krijimin e mostrës përfaqësuese, për vlerësimin e treguesve agrokimikë dhe paraqitja në skemë, fillon në pikën "M1" dhe vijon gjatë gjithë gjatësisë së diagonales, në distanca saktësisht të barabarta (D), marrja e mostrës së pikës "M2", "M3" deri në mostrën ndihmëse të fundit "Mn".

4. Mostra për qëllime analizash depozitohet në laboratorin e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë.

5. Kryerja e analizave në laborator bëhet sipas metodave mbi të cilën është kryer studimi i bonitetit të tokave ose metodave të tjera ekuivalente.

6. Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë, përgatit raportin e analizave dhe raportin teknik, dhe në përputhje me konkluzionet, propozon kalimin e sipërfaqes së tokës në tokë bujqësore ose refuzimin e kërkesës. QTTB-ja e Fushë-Krujës ruan për një periudhë 12-mujore kampionet dhe mostrat e analizuara dhe rezultatet e tyre, si dhe ruan në aparatin e GPS-së të dhënat koordinative të vendhapjes së profilit.

7. Analizat, raporti teknik, konkluzionet dhe një kopje e praktikës depozitohen në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë dhe një kopje i dorëzohet subjektit kërkues. Subjekti kërkues i drejtohet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me dokumentacionin përkatës për ndryshimin e zërit kadastral.

8. Dokumentacioni shqyrtohet nga Struktura e Administrimit të Tokave në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e cila përgatit raport përmbledhës për ministrin, bashkë me projekturdhrin përkatës.

II. Depozitimi i urdhrit të ndryshimit të resursit

1. Një kopje origjinale e urdhrit të ministrit i dërgohet Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në qark, aty ku ndodhet toka. Ky institucion, në bazë të përcaktimeve të urdhrit të ministrit dhe referuar legjislacionit aktual, bën ndryshimin dhe e pasqyron në regjistrin e tokës.

2. Një kopje origjinale e urdhrit të ministrit depozitohet në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, një kopje në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, aty ku ndodhet toka.

III. Dispozita të fundit

1. Ngarkohen për zbatimin e udhëzimit Struktura për Administrimin e Tokës në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

Lidhja nr. 1

SKEMA E VENDHAPJES SË PROFILEVE PËR VLERËSIMIN E TREGUESVE PEDOLOGJIKË

Qarku..... ; komuna/bashkia .....; fshati .....;
Zona kadastrale nr.....; sipërfaqja ..... m^2 ;

a – në parcela (pronësi) me forma të rregullta gjeometrike:

a/1 formë katrori

pozicioni i parcelës



Legjenda:

O – Pikënisja e trajektores për hapje profili

N- Pikëmbërritja (fundore) e trajektores për hapje profili

1 - Vendhapja e profilit ose pika e mesme e distancës ndërmjet (O) dhe (N)

1=ON/2

Shkalla: 1:1000

Pozicioni i vendhapjes së profilit

(gradë, minuta, sekonda)

a/2 formë katërkëndëshi



b- në parcela (pronësi) me forma të çrregullta gjeometrike



Lidhja nr. 2

SKEMA E VENDMARRJES SË MOSTRAVE NDIHMËSE PËR KRIJIMIN E MOSTRËS PËRFAQËSUESE PËR VLERËSIMIN E TREGUESVE AGROKIMIKË

Qarku..... ; komuna/bashkia .....; fshati .....;
Zona kadastrale nr .....; sipërfaqja ..... m^2 ;

a – në parcela (pronësi) me forma të rregullta gjeometrike:
a/1 formë katrori

pozicioni i parcelës



Legjenda:
O – Pikënisja e trajektores për hapje profili
N- Pikëmbërritja (fundore) e trajektores për hapje profili
1 - Vendhapja e profilit ose pika e mesme e distancës ndërmjet (O) dhe (N)
1=ON/2
Shkalla : 1:1000

a/2 formë katërkëndëshi



b- në parcela (pronësi) me forma të çrregullta gjeometrike



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2020 - Numri: 130
Datë: 2020/07/13 15:25:10
512f1dec-413f-4827-9b90-13740028038f

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë